

V E N D I M
Nr.38, datë 26.1.2001

**PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË TË PERSONAVE, QË NDIHMOJNË POLICINË, DHE
TË PUNONNJËSVE TË POLICISË, QË U KËRCËNOHET JETA, FAMILJA DHE PRONA,
PËR SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 34, dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë për:
 - a) personat që u kërcënohet jeta, familja dhe prona, për shkak të të dhënave që i japin policisë, për ngjarje ose autorë veprash penale;
 - b) punonjësit e policisë, të cilëve, për shkak të detyrës, u kërcënohet jeta, prona dhe familja.Me mbrojtje të veçantë, në këtë vendim, do të kuptohen masat, me karakter organizativ dhe profesional, për ruajtjen fizike të personave të përmendur në shkronjat "a" dhe "b", që në vijim do të quhen "persona të kërcënuar".
2. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të përcaktohen, me urdhër të ministrit të Rendit Publik, struktura që do të merret me çështjet e mbrojtjes së veçantë të personave të kërcënuar dhe detyrat funksionale të kësaj strukture.
3. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë krijohet komisioni i posaçëm (KVK), me këtë përbërje:
 - a) Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit..... kryetar
 - b) Drejtori i Policisë Kriminale.....anëtar
 - c) Shef i strukturës, që do të caktohet sipas pikës 2 të këtij vendimi.....anëtar
 - ç) Drejtori i policisë së qarkut ku banon personi i kërcënuar.....anëtar
 - d) Drejtori i Forcave Sociale e të Ndërhyrjes së Shpejtë.....anëtar,i cili shqyrton kërkesat për mbrojtje të veçantë të paraqitura nga:
 - drejtoria e policisë së qarkut;
 - personi i kërcënuar apo përfaqësuesi i tij ligjor;
4. Kërkesa, që i paraqitet komisionit të vlerësimit të kërcënimeve, duhet të përmbajë:
 - a) gjenealogjet e plotë të subjektit që kërcënohet;
 - b) rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të kërcënimeve;
 - c) shkaqet e kërcënimit dhe rrethanat e tjera, që e detyrojnë subjektin të paraqesë kërkesën.
5. Komisioni i vlerësimit të kërcënimeve, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje të veçantë, vendos:
 - a) Pranimin e kërkesës.Në këtë rast përcakton edhe masat konkrete të mbrojtjes, të cilat kanë të bëjnë me:
 - ruajtjen fizike;
 - ruajtjen e banesës a të pronës së personit;
 - transferimin e tij;
 - dërgimin jashtë shtetit;
 - masa të tjera të varësi të çështjes.
- b) Mospranimin e kërkesës.
6. Vendimi i komisionit të vlerësimit të kërcënimeve miratohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe përmban:
 - a) Pjesën hyrëse, d.m.th, subjektin që ka bërë kërkesën, kohën dhe vendin e marrjes së vendimit, përbërjen emërore të komisionit.
 - b) Pjesën përshkuese, ku jepen rrethanat që e kanë shtyrë subjektin për të bërë kërkesën, veprën penale të kryer, personalitetin e të kërcënuarit, rrezikshmërinë shoqërore të kërcënimeve dhe vlerësimet për të dhënat që zotërohen rreth një fakti të tillë.
 - c) Pjesën vendimmarrëse, ku përcaktohen masat konkrete për mbrojtjen e veçantë, kohën,

ekzekutuesin e vendimit, afatin e zgjatjes së masave, shpenzimet dhe subjektin që do t'i përballojë këto shpenzime.

7. Kundër vendimit për mospranimin e kërkesës bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, te ministri i Rendit Publik, vendimi i të cilit është përfundimtar.

8. Vendimi i komisionit të vlerësimit të kërcënimeve zbatohet nga struktura përkatëse, e ngarkuar për këtë qëllim, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

9. Shpenzimet për realizimin e mbrojtjes së veçantë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rendit Publik, ose nga subjekti shtetëror, që ka paraqitur kërkesën.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ngarkohet ministri i Rendit Publik për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi dhe për miratimin e akteve në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta